

LIGJI

MBI TË DREJTAT DHE LIRITË E POPUJVE PAKICË

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Mali i Zi, në përputhje me Kushtetutën, kontratat ndërkombëtare të verifikuara dhe të publikuara dhe rregullat përgjithësisht të pranueshme të së drejtës ndërkombëtare, u siguron popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, gjegjësisht, pjesëtarëve të tyre, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara për të gjithë qytetarët, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të posaçme të pakicave.

Neni 2

Popuj pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale, sipas këtij ligji, është grupi i shtetasve të Malit të Zi, numerikisht më i vogël nga popullata mbizotëruese, që ka karakteristika të përbashkëta etnike, fetare dhe gjuhësore, të ndryshme nga popullata tjetër, historikisht i lidhur me Malin e Zi dhe është i motivuar me dëshirën që të shprehë dhe të ruajë identitetin nacional, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Neni 3

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale mund të realizojnë të drejtat e veta dhe të gëzojnë liritë veç e veç ose në bashkësi me të tjerët.

Neni 4

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale janë të barabartë me shtetasit e tjerë dhe gëzojnë mbrojtje ligjore të njëjtë. E kundërligjshme dhe e dënueshme është çdo shkelje e të drejtave të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera nacionale.

Neni 5

Popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre, krahas të drejtave të parapara me rregullat ndërkombëtare të pranuar në përgjithësi dhe kontratave ndërkombëtare të ratifikuara, me këtë ligj u sigurohen të drejta të plota të cilat nuk mund të jenë më pak se të arriturat, në të njëjtat kushte dhe kanë si qëllim sigurimin e barazisë së tyre reale me shtetasit e tjerë.

Neni 6

Mali i Zi me shtetet e tjera lidh marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare sipas paragrafit 1 të këtij neni, Mali i Zi do të përpiqet që së bashku me ta të krijojë dhe të avancojë kushtet e

nevojshme për ruajtjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e identitetit nacional, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Neni 7

Qeveria e Malit të Zi (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) miraton Strategjinë politike të pakicave.

Me qëllim të sigurimit të kushteve për gëzimin e papenguar dhe kultivimin e veçorive nacionale ose etnike të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre, organet shtetërore janë të obliguara që, në pajtim me Strategjinë politike të pakicave, të ndërmarrin masat adekuate.

Me Strategjinë sipas paragrafit 1 të këtij neni, në mënyrë të veçantë do të definohen masat për zbatimin e këtij ligji dhe avancimin e masave dhe aktiviteteve, si dhe integrimin sa më të madh të romëve në jetën shoqërore dhe politike të Malit të Zi.

II. TË DREJTAT DHE LIRITË E POPUJVE PAKICË DHE KOMUNITETEVE TË TJERA NACIONALË TË PAKICAVE DHE TË PJESËTARËVE TË TYRE

Neni 8

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale e pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e shprehjes, të ruajtjes, të zhvillimit, të transmetimit dhe deklarimit publik të identitetit nacional, etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si pjesë të traditës së tyre.

Mali i Zi do të zhvillojë dhe avancojë studimin e historisë, traditës, gjuhës dhe kulturës së popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Në pajtim me këtë ligj dhe detyrimet e pranuar ndërkombëtare, organet kompetente sigurojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 9

Me qëllimin e ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit nacional ose etnik, popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të themelojnë institucione, shoqëri, shoqata dhe organizata joqeveritare në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Në financimin e organizatave sipas paragrafit 1 të këtij neni merr pjesë edhe Mali i Zi, në pajtim me mundësitë materiale.

Neni 10

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale kanë të drejtë që në mënyrë të pavarur dhe të lirë të përcaktojnë nacionalitetin, të drejtën e zgjedhjes së lirë dhe përdorimin e emrit personal dhe familjar si dhe emrat e fëmijëve të vet, si dhe të drejtën e regjistrimit të atyre emrave në librat e amzës dhe në dokumentet personale në gjuhën dhe në alfabetin e vet.

Të drejtën e emrit dhe regjistrimit të emrave në gjuhën dhe alfabetin e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale mund të shfrytëzojnë edhe organizatat sipas nenit 9 të këtij ligji.

Neni 11

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale përbëjnë shumicën ose një numër të konsideruar të popullsisë, sipas rezultateve të regjistrimit të fundit, në përdorim zyrtar është edhe gjuha e këtyre popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Përdorimi zyrtar i gjuhës së popujve pakicë dhe i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nënkupton posaçërisht: përdorimin e gjuhës në procedurën administrative dhe gjyqësore dhe gjatë zbatimit të procedurës administrative e gjyqësore, tek lëshimi i dokumenteve publike dhe plotësimit të evidencave zyrtare, në fletën e votimit dhe materialin tjetër të zgjedhjeve dhe në punën e organeve përfaqësuese.

Në territorin e vetëqeverisjes lokale sipas paragrafit 2 të këtij neni, emrat e organeve që kanë kompetenca publike, emërtimi i njësisë së vetëqeverisjes lokale, emërtimi i lagjeve të banuara, shesheve dhe rrugëve, institucioneve, ndërmarrjeve afariste e të tjera dhe toponimeve shkruhen edhe në gjuhën dhe në alfabetin e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 12

Popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre u sigurohet liria e informimit në nivelin e standardeve të cilave u përmbahen dokumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale kanë të drejtë të themelojnë lirisht medie dhe punë të papenguar të bazuar në: lirinë e shprehjes së mendimit, hulumtimit, grumbullimit, përhapjes, publikimit dhe pranimit të informacioneve, qasjen e lirë të gjitha burimeve të informacioneve, mbrojtjes së personalitetit dhe dinjitetit të njeriut dhe rrjedhën e lirë të informacioneve.

Organet kompetente dhe programore të medieve, themelues i të cilave është Mali i Zi, sigurojnë numrin e duhur të orëve për transmetimin e programeve informative, kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese në gjuhët e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe të pjesëtarëve të tyre, si dhe përmbajtje programore që kanë të bëjnë me jetën, traditën dhe kulturën e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe sigurojnë mjete financiare për financimin e këtyre përmbajtjeve programore.

Përmbajtjet që kanë të bëjnë me jetën, kulturën dhe identitetin e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale transmetohen së paku një herë në muaj, në gjuhën zyrtare, përmes shërbimeve publike.

Mali i Zi, në pajtim me mundësitë e veta materiale, mund të sigurojë përkthimin (titlimin) e programeve nga gjuhët e pakicave në gjuhën zyrtare.

Qeveria mund të ndërmarrë edhe masa inkurajuese që në kuadër të programeve të tjera në radio dhe televizion të sigurojë transmetimin e përmbajtjeve programore sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 13

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e shkollimit në gjuhën e vet dhe përfaqësimin adekuat të gjuhës së tyre në arsimimin e përgjithshëm dhe profesional, në varësi nga numri i nxënësve dhe mundësive financiare të Malit të Zi.

Të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni realizohen në të gjitha shkallët e edukimit dhe arsimimit.

Të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni realizohen përmes shkollave të veçanta ose paraleleve të veçanta në shkollat e rregullta.

Mësimi bëhet në tërësi në gjuhën e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Kur mësimi bëhet në gjuhën e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale detyrimisht mësohet gjuha dhe alfabeti zyrtar.

Nxënësit dhe studentët që nuk u përkasin popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale mund të mësojnë gjuhën e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale me të cilat jetojnë së bashku.

Neni 14

Paralelja me mësim në gjuhën dhe alfabetin e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale mund të themelohet edhe për një numër më të vogël nxënësish nga numri i përcaktuar për punën e këtij institucioni, por ai nuk mund të jetë më i vogël se 50% e numrit të nxënësve të përcaktuar me ligj.

Neni 15

Programet e lëndëve për nevojat e arsimimit sipas nenit 13, paragrafi 1 të këtij ligji, përmbajnë tema nga fusha e historisë, artit, letërsisë, traditës dhe kulturës së popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Para miratimit të programit të lëndëve që shprehin veçanti të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, Këshilli i Popujve Pakicë dhe i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, i jep mendim organit kompetent për miratimin e programeve të lëndëve.

Programi arsimor në institucionet dhe shkollat me mësim në gjuhën zyrtare përmban tema nga gjuha amtare dhe letërsia, historia, arti dhe kultura e popujve pakicë dhe e komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe përmbajtje të tjera që inkurajojnë tolerancën dhe bashkëjetesën.

Në territoret ku është në përdorim zyrtar edhe gjuha e popujve pakicë dhe e komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, programi arsimor në institucionet në gjuhën zyrtare mund të përmbajë edhe mundësinë e mësimin të gjuhë së popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 16

Për nevojat e arsimimit të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, në zbatim të nenit 13 paragrafi 1 të këtij ligji, në kuadër të arsimimit të lartë mund të sigurohen katedra, fakultete ose institute për arsimimin e edukatorëve, mësuesve

dhe arsimtarëve në gjuhën e këtyre popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Me qëllim të pjesëmarrjes efektive të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, Mali i Zi mund të inkurajojë bashkëpunimin ndërkombëtar arsimor, shkencor dhe teknik, me qëllim që t'u mundësojë pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale të studiojnë jashtë në gjuhën amtare dhe kështu diplomat e fituara të pranohen, në pajtim me ligjin.

Neni 17

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të themelojnë institucione edukativo-arsimore.

Financimi i institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni është obligim i themeluesit.

Neni 18

Punën edukative dhe arsimore në institucionin shkollor ose klasën e veçantë të shkollës së rregullt me mësim në gjuhën e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale e kryejnë arsimtarët nga radhët e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale të cilët kanë njohje aktive të gjuhës së popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, gjegjësisht, arsimtarët që nuk janë nga radhët e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në fjalë, kurse kanë njohje aktive të gjuhës dhe të alfabetit të këtyre popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Drejtori i institucionit shkollor që e themelon Mali i Zi ose komuna me mësim në gjuhën dhe alfabetin e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale që plotësojnë kushtet në paragrafin 1 të këtij neni, zgjidhet në pajtim me ligjin.

Organi kompetent i administratës shtetërore është i obliguar që para zgjedhjes së personit nga paragrafi 2 i këtij neni, të marrë mendimin e Këshillit të këtyre popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 19

Me qëllim të gëzimit të Drejtave të Pakicave, Universiteti i Malit të Zi, me propozim të Këshillave të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, mund regjistrojë çdo vit shkollor një numër të caktuar studentësh, pjesëtarë të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, në pajtim me aktin e Universitetit.

Neni 20

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e përdorimit të simboleve nacionale, në pajtim me ligjin.

Neni 21

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të shënojnë datat e rëndësishme, ngjarjet dhe personalitetet nga tradita dhe historia e vet.

Neni 22

Pjesëtarët e popujve pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që të organizohen lirisht, në pajtim me ligjin dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare mbi lirinë e organizimit.

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të shfaqin interesat e veta, të marrin pjesë efektive në pushtet dhe në kontrollin publik të pushtetit.

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre, për të realizuar interesat e përbashkëta, mund të bashkëpunojnë me organizatat qeveritare dhe joqeveritare në vend dhe jashtë.

Neni 22a

Përfaqësimi autentik i popullit pakicë, gjuha e të cilit është në përdorim zyrtar në Mal të Zi dhe e komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në Kuvendin e Malit të Zi dhe kuvendet e njëjste të vetëqeverisjes lokale në të cilat ata përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës, sigurohet sipas parimit të aksionit afirmativ, në pajtim me legjislacionin zgjedhor.

Neni 23

Ka pushuar të jetë në fuqi me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMZ (“Gazeta zyrtare e RMZ”, nr 51/06)

Neni 24

Ka pushuar të jetë në fuqi me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMZ (“Gazeta zyrtare e RMZ”, nr 51/06)

Neni 25

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale kanë të drejtën e përfaqësimit proporcional në shërbimet publike, organet e pushtetit shtetëror dhe të qeverisjes lokale.

Për përfaqësimin e pjesëtarëve të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkujdesen organet kompetente përgjegjëse për çështjet e kuadrove, në bashkëpunim me Këshillat e popujve pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale.

Neni 26

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e marrjes dhe propozimit të vendimeve të organeve shtetërore që janë me interes për realizimin e të drejtave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, në pajtim me ligjin.

Pjesëmarrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbëhet nga konsultimet, sondazhet e opinionit publik, dialogu dhe veprime të posaçme të atyre me të cilët këto vendime kanë të bëjnë drejtpërdrejt.

Neni 27

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale nga neni 11 paragrafi 2 i këtij ligji, statuti, vendimi ose ndonjë akt tjetër i përgjithshëm të cilin e miratojnë organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale shkruhen dhe botohen në gjuhën zyrtare dhe në gjuhën e alfabetin e popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 28

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat shumicën ose një pjesë të konsiderueshme të popullatës e përbëjnë popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale, vetëqeverisja lokale është e obliguar që, në kuadër të planit dhe programit për pjesëmarrjen efektive të popullatës lokale në kryerjen e punëve publike dhe miratimin e planit dhe programit të veçantë, përmes Këshillave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në fjalë, të sigurojë kushte për pjesëmarrje të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në miratimin e programeve të zhvillimit të komunës, planeve hapësinore dhe urbanistike, buxhetit dhe akteve të përgjithshme me të cilat përcaktohen të drejtat dhe obligimet e qytetarëve dhe rregullohet mënyra dhe procedura e pjesëmarrjes së popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në kryerjen e punëve publike dhe të përcaktojë organin që do të zbatojë debatin publik për këto dhe akte të tjera.

Neni 29

Nëse deputetët e zgjedhur në bazë të parimit të aksionit afirmativ, e në pajtim me legjislacionin e zgjedhjeve, janë të mendimit që akti i propozuar ose rregulla cenon dukshëm interesat e këtyre popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, për këtë, paraqitësi i propozimit dhe këta deputetë do të harmonizojnë qëndrimet.

Harmonizimi, në kuptimin e paragrafit 1 të këtij neni, ka të bëjë me:

- çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimin e strukturës etnike të popullatës në kundërshtim me nenin 39, paragrafi 1 i këtij ligji;
- çështjet që kanë të bëjnë me përmbajtjet e programeve arsimore pa mendimin e Këshillave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale;
- çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe nacional të popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 30

Të drejtat nga nenet 9, 12, 13 dhe 17 të këtij ligji realizohen në pajtim me dispozita të veçanta.

Neni 31

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të krijojnë dhe të mbajnë raporte të lira e paqedashëse përtej kufirit me shtetet amë dhe bashkëkombësit që qëndrojnë në shtetet e tjera, sidomos me ata me të cilët kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

E drejta nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të realizohet në kundërshtim me interesat e Malit të Zi.

Neni 32

Popujt pakicë dhe komunitetet e tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre mund të marrin ndihmë materiale dhe financiare nga organizatat vendase dhe të huaja, fondacionet dhe personat privatë.

Në rastin e ndihmës financiare ose të ndonjë ndihme tjetër materiale shoqatave, institucioneve, shoqërive dhe organizatave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera të pakicave nacionale nga jashtë, shteti mund të sigurojë lehtësime adekuate tatimore dhe lehtësime të tjera ose mund të lirohen nga dogana, në pajtim me ligjin.

Neni 33

Populli pakicë ose komuniteti tjetër i pakicave nacionale dhe pjesëtarët e tyre, me qëllim që të ruajnë identitetin e përgjithshëm nacional dhe që të avancojnë liritë dhe të drejtat, mund të themelojnë Këshillin e këtij populli pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Populli pakicë ose komunitetet e tjera të pakicave nacionale mund të themelojë vetëm një Këshill.

Këshilli i popullit pakicë ose i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale emërohet në periudhën prej katër vjet.

Këshilli i popullit pakicë ose i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale ka më së paku 17 anëtarë.

Këshillin e popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale e përbëjnë anëtarët sipas funksionit: deputetët dhe anëtarët e Qeverisë prej radhëve të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në fjalë, kryetarët e komunave, kryetarët e komunave urbane, kryetarët e kuvendeve të komunave urbane, kryetarët e partive të përfaqësuara në Kuvendin e Malit të Zi, kuvendin e komunës, kuvendin e komunës urbane, nga radhët e popullit pakicë ose komunitetet e tjera të pakicave nacionale.

Anëtarësinë e vet në Këshillin e popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, personat nga paragrafi 5 i këtij neni, e konfirmojnë me deklaratën për pranimin e anëtarësisë.

Anëtarët e tjerë të Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale zgjidhen me votim të fshehtë, në kuvendin elektoral të këtij populli pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Të drejtën e pjesëmarrjes në kuvendin elektoral e ka çdo qytetar i moshës së rritur-pjesëtar i popullit pakicë ose i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në fjalë.

Në kuvendin e elektorëve nuk mund të marrin pjesë personat nga paragrafi 5 i këtij neni dhe anëtarët e organeve të partive politike.

Organi i administratës shtetërore kompetent për të drejtat e pakicave (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) miraton rregullat dhe udhëzimet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Rregullat nga paragrafi 10 i këtij neni përmbajnë: numrin e anëtarëve të Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, thirrjen dhe mënyrën e punës së kuvendit elektoral, si dhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në kuvendin elektoral.

Anëtarët e Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale zgjedhin me votim të fshehtë nga radhët e veta kryetarin dhe sekretarin e Këshillit.

Këshilli i popullit pakicë ose i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale miraton buxhetin, statutin dhe rregulloren për punën e vet me të cilat rregullohen çështje të rëndësishme për punën e këtij Këshilli.

Mjetet për financimin e Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale sigurohen nga buxheti i Malit të Zi.

Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së Këshillit të popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale e kryen Ministria ose organi punues kompetent i Kuvendit të Malit të Zi.

Këshillat e popullit pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale janë të obliguara që, të paktën një herë në vit, deri më 31 mars të vitit në vazhdim, t'i paraqesin Ministrisë ose organit punues kompetent të Kuvendit të Malit të Zi raportin për punën dhe veprimtarinë financiare.

Neni 34

Evidencën e Këshillit sipas nenit 33 të këtij ligji e udhëheq Ministria.

Me regjistrimin në evidencë, Këshilli fiton kuptimin e personit juridik.

Formularin dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës Këshillit ia përcakton Ministria.

Vendimi për regjistrimin e Këshillit në evidencë botohet në “Gazetën zyrtare të Malit të Zi”.

Neni 35

Këshilli:

-prezanton dhe përfaqëson pakicën;

-i paraqet propozimin organeve shtetërore, organit të qeverisjes lokale dhe shërbimeve publike për avancimin dhe zhvillimin e të drejtave të popujve pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre;

-i paraqet Presidentit të Malit të Zi iniciativën që të mos e shpallë ligjin me të cilin cenohen të drejtat e popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre;

-marrin pjesë në planifikimin dhe themelimin e institucioneve edukativo-arsimore;

-jep mendimin për programet e lëndëve që shprehin veçantitë e popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale;

-propozon regjistrimin e një numri të caktuar studentësh në Universitetin e Malit të Zi;

-ndërmerr iniciativa për ndryshimin e dispozitave dhe akteve të tjera me të cilat rregullohen të drejtat e pjesëtarëve të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale;

-kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin;

Për çështjet për të cilat diskutojnë organet e pushtetit shtetëror dhe shërbimeve publike, kurse kanë të bëjnë me të drejtat e popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre, realizohet bashkëpunimi i nevojshëm me Këshillin, për të ndërtuar besimin e ndërsjellë.

Organet shtetërore dhe organet e tjera, në afatin prej 30 ditësh nga ndërmarrja e iniciativës ose kërkesës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, të njoftojnë Këshillin për masat që janë ndërmarrë.

Neni 36

Kuvendi i Malit të Zi, për të mbështetur aktivitetet me rëndësi për ruajtjen dhe zhvillimin e veçantive nacionale, gjegjësisht etnike të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre në fushën e identitetit nacional, kulturor, gjuhësor dhe fetar, themelon Fondin për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave në këto dhe fusha të tjera (në tekstin e mëtejshëm: Fondi).

Me aktin për themelimin e Fondit përcaktohen organet e Fondit, mandati, kompetenca dhe mënyra e punës së tyre dhe e vendimmarrjes, përbërja dhe numri i anëtarëve të organeve drejtuese, si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Fondit.

Në organet drejtuese të Fondit, secili Këshill i popujve pakicë ose i komuniteteve të tjera të pakicave nacionale ka përfaqësuesin e vet.

Neni 36a

Fondi financohet nga buxheti i Malit të Zi dhe nga burime të tjera.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni shpërndahen në:

-mjete për punën e Fondit dhe

-mjete për financimin e projekteve në bazë të aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Mjetet nga paragrafi 2 alineja 2 e këtij neni shpërndahen me anë të konkursit publik në bazë të kriterëve në vijim:

-kontributit që projekti i jep ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit nacional, kulturor, fetar, gjuhësor dhe etnik;

-pajtueshmërisë së projektit me dokumentet strategjike të Qeverisë;

-transparencës dhe mundësisë së kontrollit të realizimit të projektit;

-besueshmërisë ndaj paraqitësit të projektit.

Të drejtën për të marrë pjesë në konkursin publik për shpërndarjen e mjeteve nga paragrafi 2, alineja 2, të këtij neni, e kanë organizatat joqeveritare dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë veprimtaria e të cilëve, gjegjësisht aktivitetet, janë të drejtuara në ruajtjen dhe zhvillimin e veçorive nacionale, gjegjësisht etnike të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre në fushën e identitetit nacional, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

III. MBROJTJA E TË DREJTAVE

Neni 37

Mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale e sigurojnë organet shtetërore, gjegjësisht vetëqeverisjet lokale dhe gjykatat.

Neni 38

Ministria i propozon Qeverisë politikën e zhvillimit dhe të ruajtjes së të drejtave të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Së paku një herë në vit, Qeveria i paraqet Kuvendit raportin mbi zhvillimi dhe mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale.

Neni 39

Ndalohet ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve me të cilat do të ndryshohej struktura e popullatës në rajonet ku jetojnë pjesëtarët e popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale, ndërsa kanë për qëllim kufizimin e të drejtave ligjore dhe lirive.

Ndalohet çdo diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë sipas cilësdo bazë, kështu pra dhe në bazë të racës, seksit, përkatësisë nacionale, prejardhjes shoqërore, lindjes ose ndonjë statusi tjetër të ngjashëm, besimit, bindjes politike etj., gjendjes materiale, kulturës, gjuhës, moshës dhe invaliditetit fizik ose psikik.

IIIa. MBIKËQYRJA

39a

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji e kryen Ministria.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Ligjet dhe rregullat e tjera me të cilat përcaktohen të drejtat e popujve pakicë ose të komuniteteve të tjera të pakicave nacionale dhe pjesëtarëve të tyre do të harmonizohen me këtë ligj më së largu në afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 41

Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme të organeve të vetëqeverisjeve lokale do të harmonizohen më këtë ligj në afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 42

Rregullat për zbatimin e këtij ligji Ministria do t'i miratojë në afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 42a

Rregullat dhe udhëzimet për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit do të miratohen në afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 42b

Këshillat e themeluar në bazë të rregullave për zgjedhjet e para të Këshillit ("Gazeta zyrtare e RMZ", nr. 46/07) vazhdojnë të punojnë deri në themelimin e Këshillave të popujve pakicë ose komuniteteve të tjera të pakicave nacionale në pajtim me këtë ligj.

Neni 43

Strategjia e politikës mbi pakicat do të miratohet në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 44

Fondi për popujt pakicë ose komunitetet e tjera të pakicave nacionale do të themelohet në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë të publikimit në “Gazetën zyrtare të Malit të Zi”.